



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
PRAKTIKË PROFESIONALE 1

Ngarkesa: 4 ects 80 orë

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Program studimi profesional dyvjeçar "Komunikim Shumëgjuhësh në Institucione dhe Ndërmarrje"

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,5, 6, 7)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të kuptojnë strukturën organizative dhe funksionimin e një ndërmarrjeje shumëgjuhëshe. Të njohin mënyrat dhe kanalet e komunikimit profesional në mjedise ndërkulturore. Të analizojnë përdorimin e gjuhëve të ndryshme në marrëdhëniet e punës dhe në dokumentet institucionale. Të dallojnë politikat gjuhësore dhe komunikative të ndërmarrjes. Të vëzhgojnë dhe interpretojnë situata konkrete të komunikimit ndërkulturor. Të identifikojnë pengesat dhe praktikatat e mira në komunikimin shumëgjuhësh.

Rezultatet e pritshme lëndore:

Në fund të praktikës, studentët do të jenë të aftë të:

1. Përshkruajnë mjedisin organizativ dhe kulturën institucionale.
2. Identifikojnë rolin e gjuhëve të huaja dhe të komunikimit shumëgjuhësh në ndërmarrje.
3. Vëzhgojnë dhe analizojnë sfidat e komunikimit ndërkulturor.
4. Reflektojnë mbi aftësitë që u nevojiten për zhvillimin profesional.